



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Dt.05.01.2010, Nr 610-2

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës të dt.21.05.2008 në pajtim me procedurat ligjore, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, përkatësisht të nenit 79 rreth detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtori i DKA-së nxjerrë këtë:

R R E G U L L O R E E P U N Ë S
për punëtorë teknik-shërbyes të institucioneve arsimore

1. Respektimi i Urdhërave dhe rregulloreve të DKA-së nëpër shkolla.
2. Respektimi i detyrave dhe përgjegjësi që i cakton Drejtori i Shkollës.
3. Respektimi i Orarit të punës.
4. Respektimi i Orarit të zilës shkollore.
5. Mirësjellja ndaj kolegëve, nxënësve dhe gjithë personelit tjetër arsimor.
6. Kryerja mirë dhe saktë e detyrave dhe obligimeve ndaj shkollës.
7. Pastrimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e objektit dhe pasurisë së shkollës.
8. Pastrimi, mirëmbajtja dhe rregullimi i tërë inventarit të shkollës.
9. Mirëmbajtja e ambientit të jashtëm (oborrit) të shkollës.
10. Pastrimi i plotojës për rreshtimin e nxënësve dhe terenet sportive.
11. Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese të shkollës.
12. Përkujdesja dhe menaxhimi efikas i mjeteve higjeno-teknike të shkollës.
13. Mirëmbajtja dhe manaxhimi efikas i lëndës djegëse të shkollës.
14. Ndezja, mirëmbajtja dhe përcjellja me kujdes e nxemjeve të shkollës.
15. Kryerja e detyrave të tjera që i cakton Drejtori i Shkollës.

Vërejtje: Për moszbatimin e kësaj rregullore do të merren masa administrative dhe financiare në pajtim me ligjet në fuqi!

Drenas,
më 05.01.2010



Drejtori i DKA-së:
Arsim Mehmeti, prof.